



Viti i XII^{te} i Botimit, Nr.1-2,
Dhjetor 2020

**QYTETET SHQIPTARE NË VITET 1920-1940
PËR PJEKJET E PARA PËR ORGANIZIMIN URBANISTIK DHE ARKITEKTONIK
TË TYRE ME TIPARE DHE SKEMA PERËNDIMORE**

Agron Mesi*

***Kërkues shkencor pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit,
Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë
Albanian University, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike,
Departamenti i Art Dizajnit, Tiranë**

Adresë kontakti: mesiagron@gmail.com

Përmbledhje

Ky punim ka për qëllim të trajtojë aspekte të modernizimit të vendit tonë, si një proces i shtrirë historikisht në kohë e hapësirë përgjatë një shekulli të tërë, atij të XX-të, që në tërësinë e tij do të njohë tri data vendimtare, tri kthesa politike ekstreme, tri projekte zhvillimi me inspirime ideologjike dhe njëkohësisht tri orientime kulturore të ndryshme. Nga ana tjetër qasjet studimore përgjatë këtij punimi do të marrin pikërisht vetëm disa dukuri të periudhës së parë të këtij rrugëtimi, që kanë të bëjnë me modernizimin urban të Shqipërisë. Ky proces ka startuar kryesisht pas vitit 1912 (një vit emblematic ky për historinë shqiptare, i cili shënon shkëputjen përfundimtare të saj nga pushtimi shekullor osman dhe hapjen ndaj modernitetit perëndimor), ndërkohë që ky modernitet urban do të mundësohet falë reformave perëndimore të mbretit Zog dhe veçanërisht nëpërmjet Protektoriatit Italian.

Fjalë çelës: *qytetet shqiptare, modernitet, urbanistikë, arkitekturë, ndërtimtari tradicionale*

Agron Mesi

ALBANIAN CITIES IN THE YEARS 1920-1940 - THE FIRST ATTEMPTS FOR THEIR URBAN AND ARCHITECTURAL ORGANIZATION WITH WESTERN FEATURES AND SCHEMES

Abstract

This paper aims to address aspects of the modernization of our country, as a process historically extended in time and space over an entire century, that of the twentieth, which in its entirety will recognize three crucial dates, three extreme political turns, three development projects with ideological inspirations and at the same time three different cultural orientations. On the other hand, the article approaches throughout this paper will take exactly some phenomena of the first period of this journey, which have to do with the urban modernization of Albania. This process started mainly after 1912 (an emblematic year for Albanian history, which marks its final break from the centuries-old Ottoman occupation and opening to Western modernity), while this urban modernity will be made possible thanks to the western reforms of the king Zogu and especially through the Italian protectorate.

Keywords: *Albanian cities, modernity, urban planning, architecture, traditional construction*

1. Hyrje

Siç dihet, mungesa e një gjuhe të shkruar i ka detyruar që herët Shqipërinë dhe shqiptarët ta njohin shpesh veten nëpërmjet shkrimeve të *tjetrit*. Kjo njohje nëpërmjet të tjerëve theksohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për njohje shkencore. Nga kjo pikëpamje shohim se edhe dokumentimin e parë topografik të qyteteve shqiptare na e japin sërish të huajt, konkretisht trupat ushtarake austro-hungareze gjatë prezencës së tyre në territorin shqiptar në kuadër të Luftës së Parë Botërore. Janë ata, që u japin shqiptarëve në vitet 1917 dhe 1918, fotografitë e para të imazhit tërësor urban të parë nga lart me sytë e “*zogut*”. Praktikisht, me këtë vështrim dhe dokumentim të parë teknik urban, si një kod deterritorializimi dhe ri-territorializimi, mund të themi se fillon dhe modernizimi i qyteteve tradicionale shqiptare, - shprehet analisti Romeo Kodra[1]. Por sidomos përgjatë periudhës kohore të viteve 20 - 40, nga qeveria e mbretit Zog dhe me praninë e Italisë fashiste, territori urban i Shqipërisë do të shndërrohet në një laborator eksperimental të prezantimit të pushtetit politik nëpërmjet aspekteve përshfaqëse të urbanistikës e arkitekturës, të përdorura si paradigma të modernitetit, të europianizimit dhe zhvillimit të vendit.

Prania dhe influencat e mëdha të Italisë në modernizimin urban të Shqipërisë, e veçanërisht

QYTETET SHQIPTARE NË VITET 1920-1940

PËRPPJEKJET E PARA PËR ORGANIZIMIN URBANISTIK DHE ARKITEKTONIK TË TYRE ME TIPARE DH
E SKEMA PERËNDIMORE

të Tiranës, përbëjnë sot objektin kërkimor të shumë studiuesve shqiptarë dhe italianë të kohës. Në tërësinë e tyre duket sikur në lidhje me këtë fokus studimi ka ndodhur një përmbysje totale e qasjes ndaj tij.

Duke u ç'politizuar dhe globalizuar, mendimi shkencor bashkëkohor shqiptar ka një vëmendje dhe optikë krejt ndryshe nga ajo e djeshmja në lidhje me influencën dhe rolin modernizues italian në urbanistikën shqiptare të gjysmës së parë të shekullit të XX. Madje jo rrallë arrihet në konkluzione (jo pa baza por gjithsesi të diskutueshme) se modernizimi i vërtetë urban me qasje perëndimore është arritur vetëm *nga* dhe *gjatë* investimeve italiane të para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, aq sa skema trajtimesh urbane (sic paraqitet ajo e “*qytetit kopsht*” e Tiranës së re), plane rregulluese (si ato të Tiranës, Durrësit, Sarandës, Vlorës, etj.), bulevarde dhe rrugë të projektuara tërësisht moderne (si bulevardi me skemës romane *kardos-dekumanos* i kryeqytetit, rruga e Durrësit, e Kavajës, etj.) dhe tipologji arkitekturore të asaj kohe (si ndërtesat qeveritare, vilat urbane dhe banesat shumëfamiljare të Shallvareve, të Aviacionit, të Tiranës së re, etj., dhe mjaft banesa urbane dhe vila pushimi të qytetit dhe zonës së plazhit të Durrësit, etj.), etj., kanë shërbyer edhe si skema, platforma bazë e shembuj retorik mbi të cilat vazhdoi aktivitetin e saj projektues dhe ndërtues urbanistika dhe arkitektura e periudhës së pas luftës, ajo socialiste.

Ngjarjet e lidhura me praninë italiane në përgjithësi në Ballkan gjatë gjysmës së parë të shek., të XX-të, janë ngjarje të përkoshme dhe të veçuara, por tepër gjurmëlënëse dhe të një rëndësie të veçantë për Shqipërinë, si një vend në transformim të madh për atë kohë. Opinioni publik shqiptar sot po bëhet gjithnjë e më i ndërgjegjshëm e më i maturuar mbi njohjen e aspekteve të veçanta të territorit të saj, gjithmonë si një udhëkryq ndërmjet kulturave të ndryshme të Lindjes dhe Perëndimit, që përbëjnë dhe elementin thelbësor të zhvillimit në vazhdimësi të një identiteti të ndërtuar në mënyrë progresive, si frut i këtyre shkëmbimeve të shtrira në kohë. Bëhet fjalë për një karakter identitar themeluar mbi asimilimin e modeleve, për më tepër të rëndësishëm, ndër të cilët ai kompleks shumëformësh, i ofruar nga arkitektura italiane që nga vitet 20 e deri në periudhën e pushtimit Italian 1939 - 43 [2]. - shprehet studiuesja bashkëkohore italiane Francesca Calace në librin e saj: “Architettura e modelli urbani nel Mediterraneo orientale”. Dhe po një studiuese tjetër italiane, në një shkrim të saj me po këtë objekt studimor, konstaton ndër të tjera se: “Arkitektura e sotme e këtyre hapësirave (bëhet fjalë për Bulevardin e Tiranës dhe Tiranën e re) e cila ka kaluar regjime të ndryshme politike që pas luftës e deri më sot, ka pësuar variacione të përdorimit si dhe modifikime të ndryshme, por duke e ruajtur stilin dhe morfologjinë e fillesës së saj italiane” [3].

Ndërkohë dhe studiues të sotëm shqiptarë si Armando Vokshi, Ariola Prifti, Albana Tollkuci,

Agron Mesi

Besnik Aliaj, Sotir Dhama, Gjergj Thomai, e të tjerë, e kanë studiuar dhe trajtuar modernitetin urban të Tiranës kryeqytet si fillesë e pranisë italiane, por dhe atë të vazhdimësisë socialiste si vijimësi e skemave prespektive urbane të propozuara dhe të zbatuara pjesërisht nga kjo prani modernizuese perëndimore.

2. Vështrim literature

Për sa i takon arkitekturës italiane, arkitekti Maks Velo në një nga botimet e tij të kohëve të fundit shkruan: *“Më duket se sado godina të tjera të ndërtohen në Shqipëri në epoka e stile të ndryshme, nuk bëjnë gjë tjetër veçse nxjerrin në pah aftësitë organizative stilistike, estetike, e etike të objekteve e komplekseve italiane që së pari i dhanë një fizionomi të re qytetit”* [4]. Ndërkohë për influencën italiane shprehet edhe Petraq Kolevica, kur thotë se: *“Pushtimi fashist italian, ndonëse i shkurtër e në gjendje lufte, për interesat e veta e për synime koloniale, bëri ndërtime deri atëherë të panjohura në Shqipëri. Megjithëse ndihej fryma e stilit të arkitekturës fashiste të Piaçentinit, në përgjithësi u bënë ndërtime të bukura me arkitekturë moderne, me materiale veshëse e punime të cilësisë së lartë”* [5].

Po kështu, për studiuesin dhe arkitektin Armand Vokshi: *“...arkitektura italiane duhet të studiohet në mundësinë për të rimarrë një gjuhë... që nuk duhet të shihet me nostalgji, por që është gjallë e që mund të merret si model...ku mund të gjenden dhe frymëzime për arkitekturën e ardhshme”* [6].

Vera Bushati, Skënder Luarasi, Albana Tollkuci, etj., në analizimet dhe studimet e tyre fokusohen dhe përpiqen të nxjerrin sa më në pah kontributin e profesionistëve të parë shqiptarë të fushës së arkitekturës dhe projektimit modern urban, duke i mëshuar pranisë dhe rolit të rëndësishëm të tyre në formimin e tipareve moderne të arkitekturës urbane shqiptare të gjysmës së parë të shekullit të XX. Edhe më herët e shtrinë kërkimin e tyre për fillesat e modernitetit urban shqiptar studiues si Pirro Thoma e Skënder Luzati, të cilët eksplorojnë modernizimin e qyteteve tradicionale të Korçës dhe Shkodrës në kapërcyell të fundshekullit XIX dhe fillimshkullit XX. Ndërkohë që ka studiues, të cilët sot nuk ndajnë të njëjtin mendim apo simpati *“pa kufi”* për praninë e modeleve urbane italiane, duke pranuar modernitetin e tyre, por pa lënë në hije *“alienimin”* fizik që i sollën kryeqytetit, tipologjinë e tyre totalitare fashiste dhe antikapin e trajtimit të hapësirës publike kryesisht si *“teatër politik”* më shumë se si hapësirë funksionalo-emocionale urbane në shërbim të qytetarëve. Të tillë janë evidentuar në shtypin e kohës studiues ndërdisiplinorë si Gëzim Qëndro, Romeo Kodra, etj. Sipas Qëndros, koncepti urban i *Bulevardit të Tiranës* dhe i *Sheshit Skënderbej*, së bashku me ndërtesat partiako-shtetërore përgjatë e rrotull tyre, të ndërtuara nga italianët, u projektuan për t'i shërbyer afishimit të autoritetit politik dhe supremacisë së sistemit totalitar fashist,

QYTETET SHQIPTARE NË VITET 1920-1940

PËRPIEKJET E PARA PËR ORGANIZIMIN URBANISTIK DHE ARKITEKTONIK TË TYRE ME TIPARE DHE SKEMA PERËNDIMOR

që e artikuloi hapësirën urbane “*jo në shërbim të individit qytetar, por të ndërveprimit të tij të detyruar me këto hapësira të kontrolluara, diktuese dhe totalitare*”, duke prishur “*karakteristikat natyrore të bashkëpranisë sociale urbane*” [7].

Përgjithësisht, edhe sipas analistit Kodra, uzurpimi kulturor i Shqipërisë, duke përfshirë këtu dhe hapësirën urbane të saj, nuk ka ndodhur menjëherë, por gradualisht, *duke e shndërruar atë* (kulturën dhe territorin shqiptar) *në një periferi të përhershme perandorish kolonizuese*. Ky modelim i hapësirës prej pushtetesh autoritare, në dispozitivin kohor-hapësinor të *Bulevardit* monumental dhe të vetë Tiranës, ka kaluar nëpër disa faza, ku e para (gjithnjë sipas këtij studiuesi), është ajo italiane para-koloniale, me stilin eklektik gjysëm modern - gjysëm klasik, që i servirej popullit shqiptar me superioritetin e tij “*perëndimor*” dhe me të cilin shqiptarët “*orientalë*” duheshin të nisnin të civilizoheshin më së fundmi. Faza e dytë prezantohet me investimet madhore koloniale, dalluar për stilin racional modern tipik fashist roman, që iu imponua shqiptarëve si alternativa e vetme për modernizim, përparim e bashkim kombëtar, por gjithnjë vetëm nën sundimin perandorak fashist. Nisur nga këto fakte, shprehet Kodra, ideja se modernia ka hyrë në Shqipëri vetëm nëpërmjet praktikave koloniale fashiste, fatkeqësisht merret si e mirëqënë dhe fat tepër i madh për shqiptarët edhe sot po aq sa dikur [8].

3. Zhvillime të mëtejshme

Mbas Luftës së Parë Botërore, në qendrat e banuara shqiptare fillojnë të vërehen ndryshime të rëndësishme urbane dhe tiparet orientale fillojnë e zbehen apo të humbasin gradualisht, sidomos në ato qytete ku borgjezia e re tregtare kishte filluar të pasurohej dhe përbënte shtresën shoqërore më të emancipuar të kohës, si në Korçë, Shkodër, Durrës, Tiranë, etj. Në këto qytete ndërmerren iniciativat e para planifikuese, që parashikojnë ndërtimin e rrugëve të gjëra e të drejta, me standarde urbanistike e kanalizime të nëndheshme, si dhe ndërtimin e banesave të kompozuar jo më mbi prioritetet *organike* të terrenit apo privatësisë dhe preferencës së subjekteve, por tashmë të sistemuara brenda parcelave dhe sipas organizimeve racionale *hipodamike*.

Në Shkodër përgjatë viteve 1910 – 1920 hapet dhe ndërtohet *Rruga e Madhe*, e projektuar në shumicën gjatësore të saj nga arkitekti Kol Idromeno. Kjo rrugë tërësisht e re u konceptua nga ana urbanistike në stilin neoklasik mesdhetar, me banesa dy-tre katëshe buzë rrugës në të dyja anët e saj, ku njësitë tregtare vendosen poshtë në katet e para, ndërsa katet e dyta e të treta përdoren si hapësira me funksion banimi familjar.

Agron Mesi



Figura 1. Fotografi të kohës, (a) FotoStudio “Marubi” - Shkodra në vitet ‘20 dhe (b) FotoStudio “Bali” - Tirana në vitet ‘30.

Pas caktimit të Tiranës si kryeqytet më 1920, në vitin 1923, pikërisht mbi bazën hartografike të realizuar para pak viteve nga trupat ushtarake austro-hungareze, u hartua dhe plani i parë urban shqiptar, ai për qytetin e Tiranës, po nga inxhinierë dhe arkitektë austriakë, me teknikun Köhler në krye të ekipit, por në këtë projektim bashkëpunon dhe arkitekti shqiptar Eshref Frashëri.

Me këtë plan të parë urban dhe përgjithësisht të plotë, synohej që struktura rrugore e Tiranës të korrigjohej e të rregullohej sipas një trajte sa më drejtkëndore, e cila duhej të gjente një përputhje sa më të madhe me rrjetin organik urban të vonë, e po ashtu të ruante drejtimet e radialeve kryesore të origjinës së hershme të qytetit. Ndërsa në ato zona që ishin të lira, plani synonte të krijonte një rrjet kuadratik urban të pastër me ndërtime banesash të tipit vila dhe rrugë të drejta. Ky plan udhëhoqi zgjerimin e *Rrugës së Durrësit*, *Rrugës së Kavajës* dhe të asaj të *Barrikadave*. Duhet thënë se Tirana filloi traditën e hapjes dhe zgjerimit të rrugëve e bulevardeve të reja mjaft vonë në krahasim me kryeqytetet e tjera të rajonit [9].

Me urbanistin Köhler gjendemi përballë gjurmëve austriake në përcaktimin e hapësirave shqiptare, kësaj rradhe jo më në fiksimin e kufijve shtetëror (si më 1913), por në planifikimin e parë urban modern shqiptar. Në një farë mënyre mund të thuhet se me përzgjedhjen e projektit austriak, shteti shqiptar zgjodhi fillimisht “*modelin austriak*” të zhvillimit urban për të ndërtuar modelin ideal të qytetërimit të vet modern, që do të materializohej fillimisht me rikualifikimin urban të Tiranës si kryeqytet i vendit [1]. Por Köhler nuk ishte italian. Për këtë arsye edhe projekti i tij kishte pak shanse të zbatohet. Mussolini dhe Italia fashiste (që siç lexohet në disa nga dokumentet “*Architetti e Ingegneri italiani in Albania*”, po investonin për të futur Shqipërinë në orbitën e tyre koloniale) bënë ç’ ishte e mundur

QYTETET SHQIPTARE NË VITET 1920-1940

PËRPJEKJET E PARA PËR ORGANIZIMIN URBANISTIK DHE ARKITEKTONIK TË TYRE ME TIPARE DHE SKEMA PERËNDIMOR

dhe e pamundur që të materializohej përshenjimi i gjurmës italiane në hapësirën urbane në Tiranë, gjurmë që do të shfaqte elementin më karakterizues të saj me dispozitivin e aksit të Bulevardit të madh [10].

Rikonceptimi urban i qytetit me qëllim përshtatjen e tij me zhvillimet e Revolucionit Industrial, modernizimin e përgjithshëm e veçanërisht të pjesëve qendrore të tij përmes hapjes së akseve të reja brenda pëlhurave urbane ekzistuese, formimit të lagjeve të reja borgjeze, ndërtimit të ishujve urbanë me forma kënddrejta, rrethuar nga rrugë të gjera e me tipologji banesash shumëkatëshe private dhe publike, vendosja e standardeve higjienike, sistemi i rrjetizimit të kanalizimeve, etj., kishin filluar në Europë që në gjysmën e parë të shekullit XIX dhe burojnë nga konceptet e praktikat urbane që solli si domosdoshmëri sistemi kapitalist i prodhimit. Zhvillimet e reja ekonomike, shfrytëzimi i krahut të punës, diferencimet e theksuara klasore dhe shtresore, por dhe kaosi urban, mbipopullimi i qyteteve me fshatarësi të konvertuar në punëtori me pagesë, kriza e strehimit për këtë kontigjent të ardhur, etj., sollën artikullimin e mjaft teorive politike e të atyre të lidhura me sferën publike, të cilat i panë dukuritë negative që shfaqti kapitalizmi në përgjithësi, por dhe ato të lidhura me hapësirën urbane, arkitekturën dhe banimin, jo si një fat i pashmangshëm, por përkundrazi si të korigjueshme e deri të mohueshme. Pra urbanistika moderne na paraqitet që në fillesat e saj si një disiplinë me origjinë të shumfishtë, sa teknike po aq dhe etike, sociale, ideologjike, politike, etj.

Përpjekjet e para për të korigjuar apo shmangur të metat e qytetit industrial të shekullit XIX, polarizohen për atë kohë në dy propozime konceptuale ekstreme: (i) Njëri koncept është ai që argumenton dhe mbështet nisjen nga fillimi, duke i kundërvënë skemave tradicionale të qytetit forma krejtësisht të reja bashkëjetëse dhe organizimesh urbane të diktuar nga teoritë sociale moderne. Partizanët e këtij koncepti përmbliidhen rreth teorizimeve utopiste të gjysmës së parë të shekullit XIX, me përfaqësues kryesorë Ouen, Sen-Simon, Furje dhe Kabe. Këta utopistë të parë modernë nuk kufizohen vetëm në skicimin teorik të qyteteve ideale të bashkëjetesës harmonike sociale, por përfshihen tepër seriozisht dhe në realizimin konkret të skemave të tilla ideologjike, etike dhe teknike urbane në hapësirën territoriale dhe shoqërinë njerëzore të kohës. (ii) Koncepti tjetër paralel, pozicionohet më së shumti në kundërshtim me të parin dhe propozon apo insiston në përpjekjet për t'i zgjidhur problemet e qytetit “*të sëmurë*” industrial të kohës duke ndërhyrë në “*shërimin*” veçmas të çdo problemi, por pa arritur dot kështu të parashikojë një vizion tërësor të organizimit të qytetit. Propozimi i dytë përfaqësohet nga specialistë urbanë dhe funksionarë administrativë të shumtë

Agron Mesi

ndër kohëra, të cilët futën juridikisht në qytete rregullat e reja të higjenës, instalimin dhe ndarjen e impianteve të ujrave të bardha dhe të zeza, rregullat, standardet dhe normativat e hapësirave, të dendësive apo largësive, të gjërësive, gjatësive e lartësive më optimale të rrugëve e ndërtesave, etj. Duke u përpjekur të gjenin instrumentat teknikë dhe juridikë rregullues apo ekuilibruës të qytetit dhe të jetesës në të, ky kontribut individësh i dha shtysë kështu lindjes së *legjislacionit urbanistik modern* botëror [11].

Edhe trajtat drejtkëndore, të propozuara në vitet 20, 30, për krijimin e lagjeve të reja në disa qytete të Shqipërisë, dhe paralelisht me to zgjerimi i arterieve kryesore ekzistuese e ndërhyrjet në fizionominë urbane organike, modernizimi i infrastrukturës urbane, sistemi-met e kanalizimet, ndriçimi me elektricitet, etj., u bënë përgjithësisht nën ndikimin e të dy skemave të mënyrës së zhvillimit të qyteteve europiane të një shekulli më parë [9].

Realizimi i skemave të para urbane moderne në qytetet e trashëguara shqiptare u krye duke hapur në to zona të reja banimi, të cilat u projektuan të ndërtohen e zhvillohen sipas sistemit *hipodomik* (racional, drejtvizor, kuadratik). Në disa qytete, si në atë të Korçës, ky koncept i ri dhe kjo praktikë urbane perëndimore gjetën një terren paraprak urbanizimi të territorit disi më të organizuar e racional. Por më së shumti skemat e reja u realizuan duke ndërhyrë në qytetin ekzistues organik, me prishje në disa raste të sistemit spontan të rrugëve e rrugicave të ngushta e me dredha. Operimet në strukturën e lagjeve ekzistuese u shoqëruan me hapjen e rrugëve të reja tregtare, të gjëra dhe të drejta, paisur me kanalizime dhe trotuare, me ndërtime godinash dy-tre katëshe buzë rrugës, në katet e para të të cilave u vendosën aktivitetet e shërbimeve apo të tregtisë, ndërsa katet e mësipërme u përdorën me funksion banimin. Të tilla ansamble urbane banim-tregëti u ndërtuan rishtazi në qytetet Shkodër, Tiranë, Durrës, Vlorë, Korçë.

Me ardhjes në pushtet të Ahmet Zogut në vitin 1925 dhe më vonë gjatë qeverisjes monarkike të tij, politika e vendit u orientua tërësisht drejt Italisë fqinje. Marrëdhëniet mes dy vendeve u forcuan nëpërmjet një aleance politiko-ushtarake, me vendosjen e së cilës qeveria italiane e kohës angazhohej të realizonte për Shqipërinë një mbështetje financiare të përgjithshme, asistencë tekniko-ushtarake dhe bashkëpunime tregtare, urbane, shkencore dhe kulturore, në shkëmbim të drejtën e marrjes së koncesioneve për shfrytëzimin e zonave të naftës, të mineraleve dhe të bujqësisë [2].

Që në fillim Italisë ju kërkua ndihmë për hartimin e planeve rregulluese të qyteteve shqiptare. Si rrjedhojë e kësaj asistence, influencat e mëdha të Italisë gjatë monarkisë së mbretit Zog, do të shfaqen dukshëm në fushën e planifikimit urban të qyteteve, në modernizimin e infrastrukturës rrugore të tyre, në ndërtimet arkitekturore me frymë perëndimore dhe në tërësi në stilin e jetesës së asaj kohe. Në vitin 1926 raportet me Italinë u forcuan nëpërmjet nënshkrimit të *Paktit të Miqësisë dhe Sigurisë*, që e bënte Shqipërinë një *Protëktorat Italian*

QYTETET SHQIPTARE NË VITET 1920-1940

PËRPEKJET E PARA PËR ORGANIZIMIN URBANISTIK DHE ARKITEKTONIK TË TYRE ME TIPARE DHE SKEMA PERËNDIMOR

në të gjitha drejtimet, dhe kjo do të favorizonte ndihmesën e konsulentëve dhe teknikëve italianë në modernizimin e shtetit shqiptar në lidhje me reformimin legjislativ, administrativ, ekonomik e urban. Në veçanti në fushën e arkitekturës dhe të planifikimit urban u përfshin arkitektë, urbanistë dhe teknikë të shumtë italianë, kryesisht të shkollës *romane* dhe *fiorentine*, me eksperiencë dhe të angazhuar që më përpara apo paralelisht në këto kohë edhe në shembuj të tjerë të territoreve neokoloniale italiane të asaj kohe [2].

Ndërsa studimet e para urbane u kryen nga specialistët austriakë, shumë të tjerat më vonë, të cilat morën karakterin e planeve më të plota rregulluese urbane për disa qytete të vendit, u ideuan e zbatuan nga urbanistët e arkitektët italianë. Sidomos për Tiranën e dekretuar kryeqytet të Shqipërisë, por pa një strukturë moderne urbane të saj si qendër e banuar e kohës e jo më si një kryeqendër urbane e shtetit, këto plane të reja tentojnë që ajo në rradhë të parë të merrte formën e një qyteti normal, e më tej të transformohej me idenë e një kryeqyteti modern.

Planet urbane të hartuara gjatë viteve 20 për Tiranën janë të shumtë dhe ndjekin njëri-tjetrin me distanca kohore të ngushta, shpesh ndryshojnë shumë pak ndërmjet tyre, më shumë mbivendosen, duke synuar përmirësime apo variante sa më të realizueshme konkretisht. Disa prej tyre do të zbatohen në territor, duke krijuar strukturën bazë të një qyteti të projektuar e jo më spontan si derimë atëherë, ndërsa disa propozime të tjera nuk u zbatuan apo u trajtuan pjesërisht, duke u mbartur si vizione prespektivore për t'u zhvilluar pjesërisht në të ardhmen. Kështu, për vetëm një dekadë, Tirana ballafaqohet me disa vizione të reja urbanistike të zhvillimit aktual e prespektiv të saj, të propozuara nga konceptualitetet e gjashtë planeve radhazi, përkatësisht nga ato të vitit 23, 25, 26, 28, 30 dhe 31 [9].

Plani i vitit 1925 për Tiranën mban vizionin projektues të arkitektit të njohur italian Armando Brasini, i ftuar nga qeveria e Zogut për të konceptuar qendrën urbane të kryeqytetit të ri shqiptar. Ky projektplan madhor urbano-arkitekturor nuk u realizua dot pasi propozimi i Brasinit vinte me vizione tërësisht impozante historiciste romane, madje duke tentuar të ndërhynte me shembje të një pjese otomane të qendrës së atëhershme të qytetit. Pikërisht shembjet e shumta që duhet të ekzekutoheshin, stili arkitekturor krejtësisht i panjohur dhe pa lidhje me kontekstin vendas si dhe kostoja tepër e lartë financiare e këtij propozimi gjigandoman, qenë arsytet e refuzimit apo mosmaterializimit konkretisht të këtij plani. Është interesante se si analisti Romeo Kodra e komenton këtë plan të parë të Brasinit për urbanizimin e ri të kryeqytetit: “*Natyrisht Mussolini-t dhe fashistëve nuk u interesonte vetëm efekti simbolik...i aksit të Bulevardit, me anë të të cilit do induktohej ndjenja e inferioritetit dhe psikoza, tek shqiptarët dhe përfaqësuesit e tyre politik (Ahmet Zogu in primis), por edhe ai*

Agron Mesi

i zhytjes së tyre në borxhe financiare, nëpërmjet spekulimeve arkitekturore që karakterizon dispozitivin “boulevard” që nga Parisi, Vjena, Roma, New Yorku e Tirana, e djeshme dhe e sotshme...të cilin një nga figurat pararojë të arkitekturës dhe planifikimit urban modern, austriaku Otto Wagner, që në 1912 e quante “vampiri spekulim që shndërron në thujtje iluzore autonominë e qyteteve”. Dhe ky spekulim fillon ekzaktësisht dhe përpikmërisht me planin dhe bulevardin e Brasini-t, një dispozitiv kontrolli urban, pa lidhje funksionale urbanistiko-arkitekturore, infrastrukturore, sociale apo kulturore me kontekstin vendas. Dhe një nga të parët që e kishte kuptuar këtë që Qemal Butka, një prej arkitektëve shqiptarë më aktivë të kohës, edhe ky i shkolluar dhe diplomuar në Austri, larg pompozitetit kulturor të Italisë fashiste, musoliniane. Në vitin 1938, në revistën “Përpyekja”, ai vë në dukje pikërisht kotësinë dhe ekzagjerimin e përmasave të bulevardit dhe të qendrës së qytetit të Tiranës, të cilat i kalonin edhe përmasat e vetë atyre “nasionale” italiane [10]. Megjithatë disa nga idetë e Brasinit dhe të planit të vitit 25 do të mbarten në planet e mëtejshme të afërta për Tiranën [9].

Politika e rikualifikimit dhe zhvillimit edhe të qyteteve të tjera të vendit, sidomos të atyre me rëndësi strategjike në resurse e pozicione gjeografike lidhur me dinamikën e reja ekonomiko-politike shqiptaro-italiane, solli ndërhyrje tipike moderne urbane në qytetin e Durrësit, ku në vitet 1927 - 1930 u hap *Rruga e Portit*, në projektimin e së cilës kontriboi mjaft dhe arkitekti shqiptar Kristo Sotiri. Edhe kjo rrugë u konceptua me pothuajse të njëjtën tipologji urbane dhe stil arkitekturor siç u projektuan rrugët e reja të kryeqytetit e të disa qyteteve të tjera kryesore të vendit. Shpejt këto rrugë të hapura tërësisht të reja, kthehen në bulevarde, dhe kur në këto qytete vihen në funksionim centralet e para elektrike, bëhet kështu i mundur dhe ndriçimi i këtyre rrugëve me elektricitet të vazhdueshëm. Qytetet e Shkodrës dhe Korçës pajisen me centrale elektrike që më 1926-tën, Tirana më 1928-tën dhe Durrësi më 1932-shin [12].

Nëse arkitektët profesionistë shqiptarë të kësaj kohe nuk u përfshin apo nuk ju dha mundësia të kontribojnë në planifikimet modernizuese urbane të qyteteve, veprimtaria e tyre që tepër e ndjeshme dhe e vlefshme në trajtimet arkitekturore të qytetit, në projektimin e banesave qytetare të porositura nga borgjezia e re tregtare vendase, nga intelektualët dhe administrata shtetërore, etj. Në përpjekjet e këtyre arkitektëve të parë profesionistë shqiptarë për ta ngritur nivelin e projektimit nga terreni praktikist i mjeshtrave popullorë, në atë profesional, bashkëkohor dhe modern, një rol të rëndësishëm luajti dhe opinioni përparimtar i kohës. Tendanca bashkëkohore u shfaqën në jetën e shtresave elitare të shoqërisë shqiptare në harkun e kohor mes dy luftërave botërore. Një pjesë e mirë e inteligjencës së shkolluar jashtë vendit kërkonte të sillte edhe në Shqipëri mënyrën e jetesës moderne të vendeve europiane ku ata ishin shkolluar, kulturuar dhe emancipuar [13]. Ndhimuan në këtë drejtim, krahas

QYTETET SHQIPTARE NË VITET 1920-1940

PËRPIEKJET E PARA PËR ORGANIZIMIN URBANISTIK DHE ARKITEKTONIK TË TYRE ME TIPARE DHE SKEMA PERËNDIMOR

faktorëve politiko-shoqëror edhe ligjet përparimtare me karakteristika të qarta të orientimit drejt mënyrës perëndimore të organizimit të shtetit dhe të jetës në përgjithësi, të ndërmarra nga sistemi në fuqi në formën e dekreteve qeveritare, siç qe p.sh., ai që ndalonte mbajtjen në publik të elementëve të skajshëm oriental të veshjes, si ferexhetë tek femrat po ashtu dhe festet turke tek meshkujt, etj.

Disa intelektualë shqiptarë, të shkolluar tashmë në perëndim dhe jo më në lindje, kryesisht në Itali, Austri, Francë, në Athinë, Beograd, Bukuresht e në metropole të tjera më të largëta, do të jenë profesionistët e parë të fushave të ndryshme, si: mjekë, dentistë, juristë, ekonomistë, agronomë, veterinerë, inxhinierë, por dhe shkrimtarë, muzikantë, piktorë, fotografë, arkitektë, etj., profesione këto jo të zotëruara deri më atëherë nga shqiptarët. Këta intelektualë të shkolluar dhe të mirëedukuar do të përpiqen seriozisht që me praninë dhe punën e tyre të sillnin në Shqipërinë e kohës diçka nga perëndimi i qytetëruar prej nga vinin të diplomuar. Marubët në Shkodër, Pietro, Keli dhe Gega, por dhe fotografë të tjerë bashkëkohës si Kristaq Sotiri në Korçë, Ymer Bali në Tiranë apo Shan Pici po në Shkodër, etj., me *“dritëshkronjat”* e tyre do të fiksonin këtë realitet dikotomik kulturor mbase më shumë dhe më plotësisht se çdokush tjetër në këtë kohë. Arkitektët e parë si Kolë Idromeno, Skënder Luarasi, Qemal Butka, Kristo Sotiri, etj., do t’ja përshtatnin kohës banesën tradicionale qytetare, por më së shumti ata do të projektonin e ndërtonin objektet e para moderne, vilat dhe banesat dy dhe tre katëshe ndanë rrugës, me dyqanet e shërbimit në katet e para. Po kështu artistët e parë profesionistë shqiptarë, muzikantë, shkrimtarë, publicistë, piktorë e skulptorë të shkolluar në akademitë perëndimore të artit, do të trajtonin në krijimtarinë e tyre subjekte të thjeshta të realitetit të kohës, por me një qasje moderne dhe me tipare të ndjeshme kombëtare, poetike, realiste e në ndonjë rast deri impresioniste. Si të tillë ata do të sillnin në atmosferën e vakët të qyteteve shqiptare, në kulturën dhe mënyrën e jetesës urbane, shenjat e para të modernitetit perëndimor.

Synimet për zhvillimin dhe modernizimin me qëllime kolonizuese të Shqipërisë nga Italia fqinje dhe influencat e mëdha të kulturës së saj perëndimore do të ndjehen të pranishme dhe gjithnjë e duke u thelluar në vitet 30. Ritmet e rritjes së ekonomisë dhe të zhvillimit të industrisë u ndjenë më shumë pas vitit 1934, kur u kapërcye kriza ekonomike botërore. Por niveli i ndryshimeve nuk ishte njëlloj për të gjitha qytetet e vendit. Kishte qytete që u përparuan më shpejt, si Korça dhe Durrësi, ku tiparet e reja u bënë mbizotëruese përgjithësisht. Në disa qytete të tjera, si në Tiranë dhe Shkodër, megjithëse të rëndësishëm si qendra urbane dhe ekonomike për kohën, për arsye të ndryshme, si të përbërjes së banorëve, të mentaliteteve,

SHKENCAT E APLIKUARA DHE EKONOMIKE

Agron Mesi

të vjetërsisë, por dhe të madhësisë së shtrirjes së tyre, ndryshimet e reja viheshin re dallueshëm kryesisht në qendrat e tyre, por ato kontrastonin mjaft me fizionominë e trashëguar që dominonte akoma periferitë. Në qytetin e Tiranës, rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve nuk ekzistonte akoma deri në vitet 1930. Me përjashtim të Bulevardit, Tirana në këto vite nuk kishte ende rrugë të asfaltuara dhe mbizotëronin lagjet dhe rrugicat orientale me baltë dhe shtëpitë e ndërtuara prej qerpiçi. Në shtypin përparimtar të kohës Tirana përshkruhet: “...i përngjet mësallës që është me dy faqe, ku herë je në Paris e herë je në Anadoll. Diku kalon maqina me shoferin dhe një zonjë, po aty kalon dhe gega, që myshterinjtë me zë të lartë fton, se s’po i shkon salepi e s’po i shitet boza...” [14].

Në disa qytete të tjera, me ndikime të hershme të kulturës orientale, si në Elbasan apo Berat, ndryshimet janë edhe më të ngadalshme dhe tiparet e vjetra të fizionomisë së këtyre qyteteve rezistojnë ende me forcë ndaj të resë. Kështu, në dëshmitë e kohës, shkruhet në vitin 1935 për Elbasanin se të shumtat e rrugëve ishin ende “*ulica*”, se vërtet ishin ndërtuar disa të pakta “*shtëpi pallate*”, por të tjerat kishin një pamje të mjerueshme, me ato dritare të vogla me kafaze druri, qyteti nuk kishte ende ndonjë rrugë që të meritonte të quhej “*boulevard*” dhe hotelet ishin ende të pakët përkundrejt haneve të shumtë [12].

Por sidomos qendrat e disa prej qyteteve më kryesore të kohës marrin një pamje të re bashkëkohore me ndërtimin e banesave të mëdha, administrative apo qeveritare, por dhe laike e fetare, me një stil arkitekturor nga më i avancuari perëndimor. Modernizohet dhe jeta e kalimi i kohës së lirë. Ndërtohen salla luksoze, kinema, klube e restorante, kafe e dyqane tregtie. Në vitin 1927 qytete si Shkodra, Korça, Tirana, Durrësi, Vlora kishin salla kinemaje ku shfaqeshin filmat e kohës [15]. Po kështu të përmendura si aktivitete të jetës moderne ishin dhe frekuentimi i lokaleve me emër të asaj kohe, si: “*Kafja e Madhe*” në Shkodër, kafe “*Kursal*” në Tiranë, klubi e kinema “*Majestik*” dhe kinema “*Luks*” në Korçë, hoteli “*Pallas*” po në Korçë, etj., të cilat janë një dukuri krejtësisht perëndimore dhe e ndryshme nga bujtinat e hanet, apo “*akshihanet*”, kafenetë, gjellëtoret e mejhanet e dikurshme orientale. Në këtë periudhë shtohen edhe lokale të reja me një karakter shërbimi dhe me arredim tërësisht perëndimor, si *kafenetë*, *baret*, *pastiçeritë* dhe *restorantet*. Për herë të parë këto shërbime të reja frekuentohen nga klientët edhe përjashta ambienteve të tyre. Tavolinat vendosen përpara këtyre lokaleve të ndërtuara kryesisht buzë rrugës dhe shërbimi preferohet të bëhen pikërisht këtu përjashta, në kontakt vizual dhe fizik me hapësirën publike, edhe ky një tregues i emancipimit të kohës sipas stilit perëndimor të jetesës “*së hapur*” qytetare, që kishte filluar të ndiqej dukshëm edhe në qytetet shqiptare. Madje në qytetin e Korçës në vitin 1930 prodhohej birra, e cila shërbehej në lokale apo tregtohej në dyqane me emrin “*Birra Korça*” [16].

QYTETET SHQIPTARE NË VITET 1920-1940

PËRPFJEKJET E PARA PËR ORGANIZIMIN URBANISTIK DHE ARKITEKTONIK TË TYRE ME TIPARE DHE SKEMA PERËNDIMOR



Figura 2. Fotografi të kohës, (a dhe b) FotoStudio “Marubi” - Shkodra gjatë viteve ‘30.



Figura 3. Fotografi të kohës të viteve ‘30, Isituto Nazionale LUCE, (a) - Durrësi, dhe (b) - Tirana.

Agron Mesi



Figura 4. Fotografi të kohës, Korçë vitet '30, Fototeka e AQSh, (a) - Kinema “Lluks”, dhe (b) - Kinema “Majestik”

Po kështu në qytetin e Korçës, kinemaja “*Majestik*” e hapur në vitin 1927, konsiderohej nga banorët e emancipuar të Korçës si një “*La Skala e vogël*” në zemër të qytetit. Ndërsa vetë qyteti, edhe pse i ri në moshë (pasi ai merr zhvillim në fillim të shek., XIX, pas djegies për të tretën herë të Voskopojës), falë ritmeve të larta të zhvillimit në këtë fillim të shek. XX, kishte marrë një pamje të atillë, që u jepte të drejtë korçarëve ta quanin me krenari atë “*Paris i vogël*” [16].

Në disa qytete ndërtohen dhe parqe apo lulishte publike, me bimësi, pemë e lule të shumëllojshme, shoqëruar me ulëse e shatërvanë dekorativë, me hapësira publike ku vendosen dhe skulpturat apo monumentet e para të figurave kombëtare, të disa patriotëve apo intelektualëve të rëndësishëm, të cilët kontribuan që Shqipëria të bëhej komb dhe shtet, si monumenti i “*Luftëtarit të panjohur*” dhe i “*Themistokli Gërmenjit*” në Korçë (1932), monumenti i “*Çerçiz Topullit*” në Gjirokastër (1934) dhe ai i “*Luftëtarit të Pavarësisë*” në Vlorë. Të gjitha këto vepra të para të skulpturës monumentale shqiptare, të krijuara nga skulptori i mirënjohur Odhise Paskali në vitet 30 [12], të iniciuara dhe të mbështetura financiarisht nga qeveria dhe komunitetet përparimtare të qyteteve të kohës, paraqesin një tregues tjetër të përparimit të shoqërisë shqiptare, si dhe afirmimin e koncepteve bashkëkohore europiane të nderimit të patriotizmit, nacionalizmit dhe kulturës së shtetit-komb, nocione të cilat Europa e qytetëruar, dhe veçanërisht Franca moderne, i kishte vlerësuar me monumente që në shek., XVIII.

QYTETET SHQIPTARE NË VITET 1920-1940

PËRPIEKJET E PARA PËR ORGANIZIMIN URBANISTIK DHE ARKITEKTONIK TË TYRE ME TIPARE DHE SKEMA PERËNDIMOR

4. Përfundime

Reforma me tendenca të qarta për shkëputjen e Shqipërisë nga e kaluara orientale dhe hapjen e saj të plotë ndaj perëndimit (apo “Oksidentit” siç vazhdonte të quhej akoma ai), do ndërmerren vetëm në çerekun e dytë të shekullit të XX nga qeveria e mbretit Zog. Si të tilla paraqiten rradhazi disa projekte për organizime urbanistike të qendrave të banuara shqiptare me koncepte krejt të ndryshme nga ato të trashëguara otomane. Propozimet e reja vijnë të inspiruara tashmë me bazë modernitetin, përgjithësisht nga konceptet e skemat urbano-arkitekturore historiciste e racionaliste perëndimore dhe veçanarisht nga ato tipike fashiste. Ato do të ideohen e zbatohen nga urbanistë, arkitektë e teknikë italianë, të pranishëm gjerësisht me veprimtarinë e tyre në Shqipëri në atë periudhë kohore. Me praninë e Italisë fashiste, territori urban i Shqipërisë do të shndërrohet në një laborator eksperimental të prezantimit të pushtetit politik nëpërmjet aspekteve përshfaqëse të urbanistikës e arkitekturës, të përdorura si paradigma të modernitetit, të europianizimit dhe zhvillimit të vendit, por njëkohësisht dhe duke e *alienuar* këtë të fundit prej kohës aktuale dhe hapësirës së vet organike të trashëguar nga e kaluara e gjatë otomane.

Referenca

1. Kodra R. *AKS Revista*, nëntor 2018.
2. Calace F. “*Architettura e modelli urbani nel Mediterraneo orientale*”, Anna Bruna Menghini, “*Fonti documentarie tra Roma e Tirana*”, Gahemi Editore, Roma, 2006, fq. 42,43.
3. Maria Adriana Giusti, “*Albania, Architettura e Citta*”, 1925-1943, Maschietto Editore, Firenze, 2006, fq. 22.
4. Velo M. “*Betonizimi i demokracisë*”, UET Press, Tiranë, 2013, fq. 18.
5. Kolevica P. “*Arkitektura dhe diktatura*”, sh.b. Logoreci, Tiranë, 2004, fq. 17.
6. Vokshi A. “*Tracce dell’architettura Italiana in Albania 1925-1943*”, DNA Editrice, Firenze, 2014, fq. 297.
7. Qëndro G. *Sintaksa totalitare e hapësirës dhe përditësia*, Gazeta Shqiptare, suplementi letrar –artistik Milosao, tetor 2010.
8. Kodra R. *Bulevardi: një monument për konsumatorët e spektaklit*, AKS Revista, 21.05.2018.
9. Dhamo S., Thomai Gj., Aliaj B., “*Tirana, Qyteti i Munguar*”, Polis Press, Tiranë, 2016, fq. 16, 18.
10. Kodra R. *AKS Revista*, dhjetor 2017.

Agron Mesi

11. Benevolo, L., *“Origjinat e Urbanistikws Moderne”*, sh.b. Dituria, Tiranë, 2011, fq. 10.
12. Gjergji A., *“Mënyra e jetesës në shekujt XIII-XX”*, përmbledhje botimesh, sh.b. Kotti, Korçë, 2002, fq. 70, 71, 73.
13. Bushati V., *“Forum A+P”*, nr. 5, Polis Press, Tiranë, 2010, fq. 36-42.
14. Gazeta *“Rilindja”*, Korçë, dhjetor 1934.
15. Selenica T., *“Shqipëria më 1927”*.
16. Onuzi A., *Fotografitë e vjetra shqiptare dhe vlerat e tyre etnokulturore*, në *“Kultura Popullore”*, botim i QSA, Tiranë, 2010, fq. 54, 61.

Figura ilustruese

Figura 1. Fotografi të kohës

(a) FotoStudio “Marubi” - Shkodra në vitet '20, Albumi “Njerz në Za e sende të kujdesshme”, Fototeka Kombëtare “Marubi”, Shkodër, 2012,

dhe (b) FotoStudio “Bali” - Tirana në vitet '30, Fototeka e AQSh.

Figura 2. Fotografi të kohës

(a dhe b) FotoStudio “Marubi” - Shkodra gjatë viteve '30, Albumi “Njerz në Za e sende të kujdesshme”, Fototeka Kombëtare “Marubi”, Shkodër, 2012.

Figura 3. Fotografi të kohës të viteve '30.

Isituto Nazionale LUCE, Fototeka e AQSh, (a) - Durrësi dhe (b) - Tirana, <https://www.zgjohushqiptar.info/1939-1941-foto-te-rralla.htm>

Figura 4. Fotografi të kohës, Korçë vitet '30,

(a) - Kinema “Lluks” dhe (b) - Kinema “Majestik”, Fototeka e AQSh.